



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201602475/4

Tiranë ___/___/2017

Lënda : Rekomandohet kryerja e procedurës përmbarimore për refuzimin e kryerjes së veprimeve për ekzekutimin e detyrueshëm të Vendimit Gjyqësor Penal të formës së prerë nr. 1679, datë 12.12.2013, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Drejtuar : Alban GUSHO
Përmbaruesit Gjyqësor
Pranë Zyrës së Përmbarimit,

TIRANË

Për dijeni : Albert PILO
Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Përmbarimit
Gjyqësor.

E.L.
Adresa:

TIRANË

Z. Përmbarues!

Institucioni i Avokatit të Popullit, ka pranuar për shqyrtim ankesën e shtetasit E.L., në të cilën, ai, ka prezantuar shqetësimin për kryerje veprimesh përmbarimore në procesin e ekzekutimit të Vendimit Gjyqësor Penal të formës së prerë nr. 1679, datë 12.12.2013, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, për të cilin Prokuroria e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, ka lëshuar Urdhërin e Ekzekutimit nr.4850 Prot, datë 16.01.2014, me objekt;

“Dënimin e të pandehurit E.L. me 100.000 Lekë gjobë. Detyrimin e të pandehurit të paguaj gjobën brenda një viti nga dita që ky vendim merr formë të prerë”.

Referuar akteve të vëna në dispozicion prej ankuesit, rezulton se, ju z.Përmbarues, po kryeni veprime përmbarimore për ekzekutimin e detyrueshëm të Vendimit Gjyqësor Penal të formës së prerë nr. 1679, datë 12.12.2013, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, i cili nuk përbën titull ekzekutiv në kuptim dhe zbatim të parashikimeve të nenit 510, pika “e”, të K.Pr.C, nenit 467/1 të Ligjit nr.7905, datë 21.03.1995, të ndryshuar.

Shkak ligjor, i cili provon shuarjen e dënimit me gjobë të ankuesit E.L., në kuptim dhe zbatim të parashikimit të kryer në nenin 609 të K.Pr.C. është hyrja në fuqi e Ligjit Nr. 22/2014 “Për dhënie amnistie”, i cili në nenin 3/a të tij, parashikon kriteret për përfitimin e amnistisë, sipas të cilave rezulton përfitues dhe ankuesi E.L.. Referuar aktit ligjor të sipërpërmendur, ju z.Përmbarues, në referim të parashikimit të kryer në nenin 610 të K.Pr.C. do të duhet të vendosni refuzimin e kryerjes së veprimeve përmbarimore për ekzekutimin e Vendimit Gjyqësor Penal të formës së prerë nr. 1679, datë 12.12.2013, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, për të cilin Prokuroria e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, ka lëshuar Urdhërin e Ekzekutimit nr.4850 Prot, datë 16.01.2014. Për shkaqet dhe arsyet e përmendura hollësisht në shkresën nr. K2/I40-9 Prot, datë 22.02.2016, të Avokatit të Popullit, drejtuar Ministrit të Drejtësisë si dhe në shkresën nr.K2/E40-3 Prot, datë 19.12.2016, drejtuar Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, do të duhet që veprimtaria juaj në procesin e ekzekutimit të Vendimit Gjyqësor Penal të formës së prerë nr. 1679, datë 12.12.2013, të kryhet në pajtim me parimin për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, sikurse garantuar nga sanksionimi i kryer në nenin 42/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenin 6/1 të Konventës Evropiane të të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, ratifikuar me ligjin nr.8137, datë 31.07.1996 “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”.

Për arsyen e bërë të ditur, në përputhje me nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në të cilin sanksionohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”, si dhe nenin 21/b të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, i cili parashikon se : “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”,

REKOMANDOJMË

Kryerja e procedurës përmbarimore për refuzimin e kryerjes së veprimeve për ekzekutimin e detyrueshëm të Vendimit Gjyqësor Penal të formës së prerë nr. 1679, datë 12.12.2013, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë

Lidhur me shqyrtimin që do të kryhet rekomandimit të dhënë, konform nenit 19 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, kthimi i përgjigjes duhet të kryhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

Bashkëlidhur ju dërgojmë:

Kopje të shkresës nr.K2/E40-3 Prot, datë 19.12.2016, drejtuar Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Shkresën nr. K2/I40-9 Prot, datë 22.02.2016, të Avokatit të Popullit, drejtuar Ministrit të Drejtësisë

KOMISIONERI

Arben SHKEMBI

**Konceptoi dhe Daktilografoi
A.Gjoleka**